

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6989  
E mërkurë, 6 shtator 2023  
Çmimi 0.40 €

## Vazhdojnë radhët e pritjes për blerje të teksteve shkollore



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ISH-PRESIDENTI HASHIM THAÇI NGA HAGA KA FOLUR PËR VETEN, FAMILJEN, EDI RAMËN DHE TË ARDHMEN E KOSOVËS

## THAÇI: ALEANCA ME SHBA-në DUHET KULTIVUAR PËR TË ARDHMEN STRATEGJIKE, JO VEÇ PËR KUJTESË FALËNDERIMI



Pas rreth tri vjetësh që nga arrestimi i tij nga Dhomat e Specializuara në Hagë, "Gazeta Nacionale" ka realizuar një intervistë ekskluzive me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, brenda dhomave të


paraburgimit, në të cilën ai flet për veten, familjen, kryeministrin e Shqipërisë, Edi Ramën, të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, për domosdoshmërinë jetike të vendit që të qëndrojë në aleancën e përhershme me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të mos qëndrojë në një gjendje të vazhdueshme krize të njëpasnjëshme, si dhe për nevojën e përmbylljes njëherë e përgjithmonë të çështjeve me Serbinë - me njohje të ndërsjellë

TAHIRI: AMERIKANËT NUK DO TA LEJOJNË KURTIN TË FSHEHË PËRMBAJTJEN E BISEDIMEVE SIÇ KA BËRË DERI MË TASH



PËRFUNDON HARTIMI I UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR LARGIMIN E KRYETARËVE NË VERI



### AKTUALE



RAMA I SHKARKON GJASHTË MINISTRA, I PROPOZON ZËVENDËSUESIT E TYRE

ZONJA E PARË E SHBA-së REZULTON POZITIVE PËR COVID-19

KURTI TAKON DISA PENSIONISTE TË PRISHTINËS: PENSIONISTËT KANË BËRË SHUMË PËR KËTË SHOQËRI

### EKONOMI



MF-ja LANSON PROGRAMIN PËR SUBVENCIONIMIN E FATURAVE TË RRYMËS

PSE RITJJA E TË HYRAVE NË SHTET S'ËSHTË LAJM AQ I MIRË?

### SPORT



KURTI, 'DARDANËVE': ME PADURIM PRESIM FITORE NDAJ ZVICRËS DHE RUMANISË

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Rama i shkarkon gjashtë ministra, i propozon zëvendësuesit e tyre

**TIRANË, 5 SHTATOR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka shkarkuar gjashtë ministra dhe i ka propozuar zëvendësuesit e tyre, në një ndryshim rrënjësor të kabinetit qeveritar shqiptar të hënën, në pritje të dekretimit nga presidenti Bajram Begaj. Në mbledhjen e Asamblesë së Partisë së tij Socialiste më 4 shtator, Rama bëri me dije edhe për krijimin e një ministrie të re. Ai do t'ia paraqesë për dekretim këto ndryshime presidentit Bajram Begaj të martën.

Gjatë një fjalimi Rama theksoi se “nuk u ka borxh asnjë prej zyrtarëve socialistë që futen në telashe me drejtësinë”, dhe se asnjë prej tyre nuk duhet të fshihet pas flamurit të partisë që ai drejton.

Rama e shkarkoi ministrin e Punëve të Jashtme, Olta Xhaçka, dhe propozoi emërimin e Iglit Hasanit në vend të saj, ish-ambasadorit të Shqipërisë në misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Vjenë.

Largimi i Xhaçkës vjen në kohën kur Shqipëria sapo ka marrë presidencën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB).

Gjithashtu, u shkarkua nga detyra

ministrja e Bujqësisë, Frida Krifca. Ajo do të zëvendësohet nga Anila Denaj, e cila më herët ka qenë pjesë e kabinetit qeveritar si ministre e Ekonomisë dhe Financave.

Delina Ibrahimaj nuk do të jetë më ministre e Financave dhe Ekonomisë, pasi u emërua ministre e Shtetit për Sipërmarrjen, duke zënë vendin e Edona Bilalit, që u shkarkua nga ky post.

Në krye të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të vijë Ervin Mete, i cili ka qenë më herët zëvendësministër i Financave, aktualisht drejtues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në prag të nisjes së vitit të ri shkollor u shkarkua nga detyra ministrja e Arsimit, Evis Kushi, për t'u zëvendësuar me Ogerta Manastirliun.

Ndërkaq, vendin e lënë bosh prej saj në krye të Ministrisë së Shëndetësisë e zë Albana Koçiu, aktualisht drejtoreshë e Departamentit të Administratës Publike.

Rama vendosi ta shkrijë Ministrinë e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, që drejtohej nga Milva Ekonomi, në një ministri të re; Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me



Pushtetin Vendor, që do të drejtohet nga Arbjan Mazniku, aktualisht nënkryetar i bashkisë së Tiranës.

Kryeministri tha se “kryebeteja e PS” është Shqipëria evropiane.

Më 8 korrik të këtij viti Rama shkarkoi nga detyra ministrin e Brendshëm Bledi Çuçi dhe emëroi në vend të tij Taulant Ballën. Këto ndryshime ishin paralajmëruar nga kryeministri Edi Rama edhe gjatë një mbledhje

joformale të qeverisë gjatë muajit gusht.

Ai pati deklaruar se do të ketë një vetëreformim të Partisë Socialiste dhe të qeverisë së drejtuar prej tij. “Do të ketë një riorganizim dhe rikonceptim. Sesionin e ri ta nisim me një puls të ri, por edhe me një rritje të konsiderueshme të kapaciteteve qeverisëse, duke theksuar rolin e zëvendësministrave, duke i përfshirë në vendimarrje e edhe

drejtuës të agjencive të rëndësishme. Vetëreformimi është një riorganizim i procesit qeverisës në funksion të rritjes së efikasitetit dhe kapaciteteve për të arritur rezultate të shpejta”, kishte thënë Rama më 29 korrik.

Asambleja e Partisë Socialiste bëri ndryshime në të gjithë sekretariatit dhe ndryshimet pritet të miratohen në Kongresin e kësaj partie që pritet të mbahet në fillim të muajit tetor.

## Borrelli konfirmon se një diplomat suedez i BE-së po mbahet rob në Iran

**BRUKSEL, 5 SHTATOR** - Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian konfirmoi se Johan Floderus, diplomat suedez që punon për BE-në, është duke u mbajtur rob në Iran për më shumë se 500 ditë. Pas një takimi në qytetin spanjoll të Kadizit, Josep Borrell u tha gazetarëve se Brukseli po kërkon “pareshtur” që të lirohet 33-vjeçari.

Të hënën Suedia pjesërisht konfirmoi një raportim nga “New York Times” lidhur me ndalimin, duke njoftuar se një shtetas suedez, në të tridhjetat, është duke u mbajtur në Iran që nga prilli i vitit 2022.

Por, Borrelli shkoi më tej duke konfirmuar emrin e personit dhe duke treguar se ai punon për trupin diplomatik të BE-së. “Dua të flas për një rast specifik,



për rastin e zotit Floderus. Ai është shtetas suedez që punon

për Bashkimin Evropian dhe i cili është i ndaluar ilegalisht në

Iran për më shumë se 500 ditë”, tha Borrelli, duke shtuar se të

gjitha ekipet e tij në të gjitha nivelet, institucionet evropiane në koordinim të ngushtë me ato suedeze dhe familja e tij, po kërkojnë nga autoritetet iraniane ta lirojnë atë. “Në çdo takim diplomatik, në të gjitha nivelet, e kemi diskutuar këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme”, tha ai.

Ai tha se lirimi i Floderus është në agjendën e BE-së dhe të qeverisë suedeze dhe “ne nuk do të ndalemi derisa ai të lirohet”.

Në korrikun e vitit të kaluar Irani njoftoi se kishte arrestuar një person nën dyshimet për spiunazh, dy javë pasi një shtetas iranian u dënua me burgim të përjetshëm në Suedi për rolin e tij në ekzekutimet masive të mijëra kundërshtarëve politikë të kryera nga regjimi iranian më 1988.

## Zonja e Parë e ShBA-së rezulton pozitive për Covid-19

**UASHINGTON, 5 SHTATOR** - Zonja e Parë, Jill Biden, ka rezultuar pozitive me Covid-19 të hënën vonë, ka njoftuar drejtoresha e saj e komunikimit. “Ajo aktualisht

po përjeton vetëm simptoma të lehta. Ajo do të qëndrojë në shtëpi në Rehoboth Beach, Delaware”, ka theksuar Elizabeth Alexander në një deklaratë.

Presidenti Joe Biden, gjithashtu, iu nënshtrua një testi për Covid-19, por ai doli negativ. “Presidenti rezultoi negativ. Presidenti do të testohet në një ritëm të

rregullt këtë javë dhe do të jetë nën monitorim për simptoma”, ka thënë në një deklaratë sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre.



# Tahiri: Amerikanët nuk do ta lejojnë Kurtin të fshehë përmbajtjen e bisedimeve siç ka bërë deri më tash



Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se zbatimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do të jetë temë qendrore në dialogun e radhës. Tahiri ka theksuar se amerikanët tash e tutje nuk do ta lejojnë Kurtin ta fshehë përmbajtjen e bisedimeve siç ka bërë deri më tash

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se amerikanët nuk do ta lejojnë Kurtin ta fshehë përmbajtjen e bisedimeve me Serbinë siç ka bërë deri më tash. Ajo ka shkruar në "Facebook" se zbatimi i Asociacionit do të jetë temë qendrore në dialogun e radhës. "Prej diskutimit të luftës të marrëveshja pa njohje, pranimi i asociacionit, autonomi për

pakicën serbe, tensionet në veri, ndërsa tash te zbatimi i Asociacionit, që do të jetë temë qendrore në dialogun e radhës - amerikanët do të na tregojnë se çfarë u bisedua; nuk do të lejojnë Kurtin të fshehë përmbajtjen e bisedimeve siç bëri deri më tash", ka shkruar Tahiri.

Pas një periudhe tensionesh në veri dhe përplasjes në distancë me një retorikë të ashpër, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 14 shtator në Bruksel nën

ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Takimin e ka konfirmuar kreu i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, dhe i dërguari i tij për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Javën e kaluar Lajçaku takoi ndaras dy udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë dhe tha se "dy liderëve ua ka rikujtuar se të gjitha marrëveshjet e dialogut janë valide dhe se ato duhen zbatuar plotësisht dhe pa vonesë". "Në Bled unë kisha takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ne biseduam për përgatitjet për takimin e radhës të nivelit të lartë në shtator, me përqendrim te normalizimi i marrëdhënieve dhe zbatimi i deklaratës së BE-së të 3 qershorit. Po ashtu, kam ngritur shqetësimin rreth situatës në veri të Kosovës", pati shkruar Lajçak në "Facebook".

Nga Bledi, Lajçaku udhëtoi për në Beograd, ku takoi presidentin

e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Kemi biseduar në detaje për përpjekjet për ulje të tensioneve dhe mbajtje të zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës, si dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të dialogut. Ua kam kujtuar të dy liderëve se të gjitha marrëveshjet e dialogut mbesin valide dhe detyruese për të dyja palët dhe duhen zbatuar plotësisht dhe pa kushte apo vonesa", ka shkruar Lajçaku pas takimit me Vuçiqin.

Kryeministri Kurti dhe presidenti Vuçiq për herë të fundit janë takuar katër muaj më parë, më 2 maj, vetëm pak kohë pas mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri të Kosovës, zgjedhje këto të cilat janë bojkotuar nga serbët lokalë. Në muajin qershor, Bashkimi Evropian kërkoi uljen e tensioneve me kërkesë të qartë: pezullimin e operacioneve policore në veri, zhvendosjen e

kryetarëve të komunave në zyra alternative dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme me pjesëmarrje të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se tashmë ka përgjysmuar praninë e njësive të policisë në ndërtesat komunale në veri dhe është pajtuar për organizimin e zgjedhjeve të reja. Në këtë rrethanë të re qeveria kërkon që Bashkimi Evropian t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës të cilat u vendosën, sipas BE-së, në "mungesë të koordinimit dhe sjellje joevropiane lidhur me zhvillimet në veri. Bashkimi Evropian ka thënë se veprimet e fundit të qeverisë në drejtim të shtensionimit të situatës në veri janë hapa të rëndësishëm në drejtimin e duhur, por nevojiten hapa të tjerë për ta zbutur krizën në veri me zgjedhjet e parakohshme që duhet të mbahen sa më shpejt".

## Udhëzimi administrativ për kryetarët në veri, Kurti falënderon OSBE-në

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka prituri të martën në takim shëfën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe zyrës së OSBE-së në Kosovë. Ndër të tjera, kanë diskutuar

për procesin e zgjedhjeve të parakohshme në komunat në veri të Kosovës, me ç'rast kryeministri ka shprehur falënderimin e tij për mbështetjen e OSBE-së për adresimin e legjislacionit sekondar në lidhje me nenin 72 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në takim është biseduar edhe

për integrimin e komuniteteve joshumicë dhe pengesat me të cilat ballafaqohen. Në lidhje me këtë, kryeministri Kurti shprehu shqetësimin e tij në lidhje me kërcënimet dhe frikësimet nga Beogradi dhe strukturat ilegale ndaj policëve të rinj nga komuniteti serb të angazhuar së fundmi në Policinë e Kosovës.





ISH-PRESIDENTI HASHIM THAÇI NGA HAGA KA FOLUR PËR VETEN, FAMILJEN, EDI RAMËN DHE TË ARDHMEN E KOSOVËS

# Thaçi: Aleanca me ShBA-në duhet kultivuar për të ardhmen strategjike, jo veç për kujtesë falënderimi

Pas rreth tri vjetësh që nga arrestimi i tij nga Dhomat e Specializuara në Hagë, “Gazeta Nacionale” ka realizuar një intervistë ekskluzive me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, brenda dhomave të paraburgimit, në të cilën ai flet për veten, familjen, kryeministrin e Shqipërisë, Edi Ramën, të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, për domosdoshmërinë jetike të vendit që të qëndrojë në aleancën e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të mos qëndrojë në një gjendje të vazhdueshme krize të njëpasnjëshme, si dhe për nevojën e përmbylljes njëherë e përgjithmonë të çështjeve me Serbinë - me njohje të ndërsjellë. Në fillim të intervistës Thaçi thotë se “sot jam në izolim fizik, por jo burg mendor”, dhe shprehet se ka “energjinë fizike” dhe “freskinë mendore”. Por për çka është në veçanti i përmalluar, është për familjen në rend të parë, edhe për miqtë e tij jetësor

PRISHTINË, 5 SHTATOR -

**Nacionale:** Disa vjet para se të arrestoheshit disa herë e keni përsëritur se do të dilnit në pension pas përfundimit të mandatit të Presidentit. A e keni pasur përnjëmend?

**Hashim Thaçi:** Nuk më mungon zyra e Presidentit apo e Kryeministrit, as agenda apo debatet ditore politike, partiake

apo parlamentare. Pas përfundimit të angazhimit politik dhe procesit që po kaloj aktualisht, dua të jetoj kapituj të angazhimeve të tjera jetësore. Unë sot jam në izolim fizik, por jo në burg mendor.

Ndiej se kam energjinë fizike e krijuese, përvojën dhe freskinë mendore të bëjë gjëra të mira, të dobishme dhe kreative për

shoqërinë dhe vendin tim. Për qytetarët kosovarë, liria dhe pavarësia nuk duhet të jenë të mjaftueshme. Kosova ka shumë oportunitete të përcilluara; kapitali human përbën pasurinë më të çmueshme. Unë besoj në shoqërinë aktive, dinamike dhe inovative kosovare; besoj në të ardhmen e sigurt të fëmijëve tanë dhe fëmijët e fëmijëve tanë.

**Nacionale:** Çfarë ju ka marrë malli më së shumti në Kosovë?

**Hashim Thaçi:** Për familjen, të rri dhe të bisedoj i lirë: Lumen, Endritin, i cili tani u rrit dhe u bë burrë, të merrja pjesë në ceremoninë e tij të diplomimit, të shëtisja maleve, bjeshkëve të bukura të Kosovës, të përcillnim ndeshje futbollit së bashku, apo të kalonim së bashku ndonjë ditë skijimi në bjeshkët e Brezovicës. Të bisedonim për ëndrrat e tij jetësore, apo për ndonjë film apo libër etj. I mungojmë njëri-tjetrit çdo ditë, por ky është çmimi i lirisë. E di që mallëngjimi është deri-diku dobësi, por paraqet edhe njerëzi: jemi njerëz nga mishi dhe gjaku. Po, më ka marrë malli për prindërit të cilët kanë hyrë në fazën e moshës së thyer, edhe pse flas shpesh përmes telefonit. Ardhja e tyre vitin e kaluar këtu në vizitë ishte një emocion i veçantë dhe i paharrueshëm. Vizita ime para do kohësh, më 29 maj 2023, e cila u krye në ruajtje dhe shoqërim të DHSK-

së, në vendlindje në Burojë, biseda me prindërit, për disa orë, paraqet një mrekulli të jashtëzakonshme njerëzore. Koha dhe biseda me ta ishte më e veçanta në jetën time. Evokuam kujtime të së kaluarës, biseduam për rrethin e ngushtë dhe të gjerë familjar, për të sotmen, por edhe për të ardhmen. Janë të bekuar që kanë plot mbesa e stërmbesa, nipa e stërnipa. Po e jetojnë pleqërinë të qetë, krenarë dhe dinjitozë. Jam i mallëngjyer për njerëzit që i dua dhe më duan, që më besuan për më tepër se dy dekada, në procesin e përbashkët të ndërtimit të Kosovës së lirë, të pavarur, tolerante, zhvillimore.

**Nacionale:** Në fjalimin e fundit para popullit të Kosovës, ditën kur u arrestuat, një pjesë më ka lënë shumë përshtypje: ajo kur thoni të qëndrojmë së bashku dhe që të mos lejojmë të thellohem në krizë kushtetuese dhe institucionale. Çfarë keni

pasur ndërmend kur i keni thënë ato fjalë?

**Hashim Thaçi:** Unë vazhdoj të besoj se vetëm duke qëndruar të bashkuar si popull mund t'i tejkalojmë sfidat. Të bashkuar ia dolëm në procesin e lirisë dhe pavarësisë, e ashtu duhet të vazhdojmë edhe në fazën e integritetit euroatlantik. Ky unitet qytetar dhe institucional duhet të mishërohet në vlerat perëndimore, në kuptimin e ecjes përpara, e jo bashkim në kauza të gabuara. Jo të kalohet koha së bashku duke reflektuar për ballafaqimet e së kaluarës, por të hidhet shikimi kah e ardhmja. E kaluara jonë nuk është sfiduese, ajo është e fituar, është shumë krenare dhe me integritet. Atë nuk mund dhe nuk duhet të tentojmë ta ndryshojmë. Sfidat dhe zgjidhjet i kemi përpara. Njerëzit duan zhvillim, vende pune, mirëqenie, edukim cilësor, shërbim shëndetësor, ambient më të pastër etj. Duhet kujdes që, duke u marrë shumë me të kaluarën, të mos vonohet, rrezikohet apo edhe të humbet e ardhmja. Uniteti brendashqiptar dhe investimi për pajtim ndëretnik janë çelësi i suksesit për Kosovën. Bota po lëviz dhe po ndryshon më shpejt sesa intuitat apo agjendat tona lokale. Çdo krizë e vonon shumë Kosovën, por edhe i minon përpjekjet e miqve ndërkombëtarë për ta konsoliduar shtetin e Kosovës në rrafshin e brendshëm, por edhe në afirmimin e saj ndërkombëtar. Përkrahja ndërkombëtare nuk duhet të merret si e mirëqenë. Atë gjithmonë duhet merituar. Kosova çdo ditë duhet të vazhdojë të prodhojë argumente që e lehtësojnë mbështetjen e miqve ndërkombëtarë.

**Nacionale:** Mbështetja personale e Edi Ramës për ju pasi u arrestuat ka habitur shumëkënd. Ai ju quan vëlla e ju shpreh dashuri të madhe miqësore. Ne ishim dëshmitarë të raporteve të mira, edhe sa ju ishit në Kosovë. Por, a ishin gjithnjë të mira?

**Hashim Thaçi:** Kur erdhëm në Hagë, si pasojë e masave anti-Covid, i kaluam pa asnjë kontakt fizik rreth 9 muaj, madje as me familje. Nuk ishte e lehtë. Vizita e Edit ndodhi në vend dhe rrethana të jashtëzakonshme e të paimagjinueshme, përtej politikës dhe procesit gjyqësor, bisedë krejt vëllazërore. Më kishte marrë malli. Edi lufton dhe zakonisht fiton në kauzën që beson. Është impresionuese se si ai po vazhdon të ndërtojë dhe afirmojë Shqipërinë evropiane. U gëzova shumë që, pas autorizimit të shefit të parburgimit, pranova librat që Edi më kishte sjellë në objektin e parburgimit të DHSK-së. Si zakonisht, ishte me plot humor të mirë. Por, kur u ndamë, e ndjeva se u emocionua shumë, por gjithmonë me besim për të ardhmen më të mirë dhe më të

sigurt, përtej hapësirës ku qëndruam duke pirë kafe rreth dy orë. Ne besojmë në drejtësi, në të vërtetën dhe transparencën. Qytetarët e Kosovës janë të etur të shohin dhe të dëgjojnë të vërtetën. Jo të cunuar, apo të njëanshme. Kosova dhe qytetarët e saj besojnë në parimet e drejtësisë moderne, të cilat i ka përfshirë dhe i respekton edhe me kushtetutë dhe ligje shtetërore. Drejtësi që respekton standardet bashkëkohore, e shpejtë dhe efikase. Drejtësi që e fiton legjitimitetin e brendshëm. Kosova ka vuajtur shumë nga padrejtësia. Kosova ka ecur përpara vetëm duke i respektuar parimet e lirisë, drejtësisë dhe demokracisë.

**Nacionale:** Në politikën kosovare ju keni ndërtuar raporte personale edhe me figura të tjera politike. A mund ta përmendni ndonjë prej tyre që, ndoshta, edhe ju mungon sot?

**Hashim Thaçi:** Nuk do t'i ndaja njerëzit nga politika dhe jo politika. Më mungojnë miqtë me të cilët kam punuar bashkërisht mbi dy dekada, me të cilët kam ndarë gëzimin, hidhërimin, suksesin dhe dështimin, njerëzit e rrugëtimit krenar për lirinë, shtetin dhe zhvillimin e vendit. Jam i inspiruar nga këta njerëz dhe përullem me respekt dhe mirënjohje që më duruan në gabime dhe më besuan në sukses. Integriteti i këtyre njerëzve është i jashtëzakonshëm. Ani pse e dinim se rrugëtimi me mua ishte jo i lehtë dhe i shkurtër, por më i sigurti dhe i qëndrueshmi.

Bashkëpunimi me partnerë apo rivalë politikë për mua ka qenë gjithmonë respekt, kujdes dhe qëllim në vete. Gjithë jetën time politike e kam bërë me njerëz të profileve të ndryshme politike. Për mua kanë qenë gjithmonë më me rëndësi prioritetet politike e jo ato ideologjike, partiake apo individuale. Gjatë ballafaqimeve politike kam fituar shumë miq dhe kundërshtarë, por edhe janë krijuar kundërshtitë të ndryshme politike prejdukuese, por normale për shoqërinë demokratike plurale. Për mua janë të kuptueshme. U jam shumë mirënjohës të gjithëve që i kanë qëndruar familjes sime afër, por edhe për vizitat që më kanë bërë në Hagë. Por, mbi të gjitha, për besimin që tregojnë në atë që përfaqësoj. E riktheqoj, njerëzit më mungojnë, jo politika. Më kanë vizituar presidentë, kryeministra, ambasadorë, kongresmenë, politikanë, aktivistë të shoqërisë civile, udhëheqës të bashkësive fetare, veprimtarë të të drejtave të njeriut, intelektualë, akademikë, gazetarë, njerëz të artit dhe kulturës, botës së sportit, sipërmarrës, qytetarë nga Diaspora, të njohur dhe të panjohur. Të them të drejtën, u kënaqa duke biseduar për tema private, familjare dhe



profesionale. U jam shumë falënderues të gjithëve qytetarëve, kudo që jetojnë, të cilët ndajnë solidaritetin e tyre.

**Nacionale:** Ju keni pasur kohë, si asnjëherë më parë, të mendoni për gjëra të ndryshme, ndoshta edhe për luftën e fundit në Kosovë. A ka diçka të re që mund të na e thuash për atë periudhë?

**Hashim Thaçi:** Të them të drejtën, më shumë mendoj për të ardhmen sesa për kapitujt e mbyllur suksesshëm të Kosovës. Ne nuk e filluam luftën, dhe as s'e deshëm atë, populli i Kosovës i rezistoi agresorit. Nuk bëmë as më pak as më shumë sesa atë që duhej bërë, siç kanë bërë dhe bëjnë sot edhe shumë kombe bartëse të civilizimit botëror. Ne fituam. Tash duhet ta forcojmë paqen. Ajo sjell zhvillim, rend e ligj, harmoni mes njerëzve, jetë më të mirë e mirëqenie për qytetarët. Vetëm me histori nuk mund ta fitojmë të ardhmen. Historia duhet respektuar, institucionalizuar. Ajo është mishërim i qytetarëve, por nuk garanton sukses për të sotmen dhe të ardhmen.

Nëse dështojmë sot, e lëndojmë dhe e përbaltim historinë e fitores së djeshme. Por, duhet pasur parasysh se historia jonë e suksesit nuk është vetëm pronë kosovare, është edhe meritë e jashtëzakonshme e botës perëndimore. Kosova është storie e suksesit të përbashkët. Pa përkrahjen e sponsoruesve të lirisë dhe pavarësisë si shoqëri mund të mbijetojmë ngatërrueshëm disi, por si shtet funksional nuk mund të ekzistojmë. Ta mendojmë Konferencën e Rambujesë, kohën e bombardimeve, çlirimin

e Kosovës, bërjen e Kosovës shtet, njohjen e saj nga mbi 100 shtete, vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, integrimin e saj në shumë institucione dhe organizata ndërkombëtare. Duhet kujtuar se jo të gjithë faktorët relevantë botërorë ishin entuziastë për bërjen e Kosovës së lirë dhe të pavarur.

E kundërta, Kosova do ta ketë pamjen e zyrtarë, të pasigurt, dekurajuese dhe me shumë dilema. Do të jetë ekonomikisht më e varfër, fare investime të huaja dhe me demokraci të lëkundur. Një vendi me kriza të përhershme askush nuk i beson. Por, unë besoj në Kosovën në NATO, në BE dhe në raporte të përjetshme speciale me ShBA-në. Me Serbinë duhet të arrihet paqe e përhershme, me njohje reciproke, ligjërisht obliguese. Sa më shumë që vonohet kjo marrëveshje, aq më e vonuar do të jetë Kosova në NATO dhe BE, e aq më e zbehtë do të jetë mbështetja e ShBA-së. Përvoja ime më tregon se Brukseli e mbështet Kosovën, për aq sa e inkurajon dhe e mbanë në vëmendje atë Uashingtoni. Aleanca me ShBA-në duhet kultivuar për të ardhmen strategjike, e jo veç për kujtesë falënderimi. Suksesi ynë është mirënjohja më e madhe që Perëndimi mund të pranojë dhe vlerësojë nga Kosova.

**Nacionale:** Kosova po përballet me probleme të mëdha, ikjen e të rinjve. Shquheni për mesazhe përbashkuese, edhe shkaku i pozitës si president. A keni ndonjë mesazh edhe për këta të rinj: Pse duhet të rrinë në Kosovë e ta duan atë?

**Hashim Thaçi:** Largimi i të rinjve

dhe familjeve të tëra nga Kosova është shqetësues dhe paraqet alarm. Njerëzit nuk largohen pse nuk e duan atdheun, por nga mungesa e mundësive për jetë më të mirë. Me këtë trend, shumë shpejt, në pak vite, mund të kemi proporcionin e mbi gjysmës së qytetarëve kosovarë që jetojnë në Diasporë. Nuk duhet vetëm ankuar apo vajtuar largimin e tyre, por krijimin e kushteve për frendim apo zvogëlimin e këtij fenomeni. Por, askush nuk duhet të mendojë se largimin e njerëzve për në diasporë mund ta ndalë tërësisht.

Nuk duhet harruar se Kosova ishte përfituese e madhe nga diaspora. Ata investuan shumë për lirinë dhe zhvillimin e Kosovës. Tash duhet ta shndërrojmë këtë faktor në përparësi për ekonominë dhe emancipimin shoqëror. Është e njohur se shumë talentë brilantë po ikin jashtë, me këtë gjendje largimi do të rritet, pra "largimi i trurit". Uroj që të mos jetë njëdrejtimitësh...besoj që shumë shpejt do ta kemi "qarkullimin e trurit" ku njerëzit largohen, qëndrojnë jashtë e pastaj kthehen në vendet e tyre...dua të besoj se investime të ndryshme në Kosovë mund të lidhen me dijen dhe përvojën e sipërmarrësisë në Kosovë. Të rinjtë besojnë dhe ndihen krenarë me Kosovën. Të arriturat e Kosovës janë të jashtëzakonshme. Kosova është vend që ka dëshmuar se mund të bëjë mrekulli. Pra, më shumë shpresë, besim dhe optimizëm për të sotmen dhe të ardhmen e saj. Të punohet që secili qytetar, të ndihet mirë dhe krenar me Kosovën.

## MF-ja lanson programin për subvencionimin e faturave të rrymës

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka lansuar Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë ku pritet të bëhet subvencionimi i faturave të rrymës për disa kategori të shoqërisë. Në hyrje të prezantimit, kryeministri Albin Kurti tregoi se fokusi i këtij programi do të jenë personat

me aftësi të kufizuara, prindërit vetushqyes dhe pensionistët që jetojnë vetëm. "Programin që po e prezantojmë sot e që do të zbatohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka në fokus subvencionimin e faturës së energjisë për familjet që kualifikohen si konsumatorë të cenueshëm të energjisë", ka thënë Kurti, duke shtuar se

fokus të veçantë në këtë program do të kenë grupe të caktuara të shoqërisë, personat me aftësi të kufizuara, prindërit vetushqyes dhe pensionistët që jetojnë vetëm. Edhe menaxheri i Bankës Botërore në Kosovë, Massimiliano Paolucci, ka thënë se do ta përkrahin Kosovën jo vetëm për energji, por në të gjitha fushat.



## Hyn në fuqi marrëveshja Shqipëri - Kosovë për lehtësimin e procedurave doganore

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Është publikuar në fletoren zyrtare marrëveshja e nënshkruar në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, në Tiranë, e cila synon lehtësimin e procedurave doganore për inspektimin e produkteve me origjinë joshgazore. Ajo është miratuar në mbledhjen e fundit të qeverisë shqiptare më 30 gusht. Marrëveshja, e cila ka një kohëzgjatje prej pesë vjetësh dhe që mund të ripërsëritet, ka për qëllim promovimin e tregtisë, heqjen e barrierave dhe lehtësimin e procedurave të kontrollit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, me synim forcimin dhe shtrirjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë.



Sipas marrëveshjes, "palët bien dakord se kontrolli në import, transit dhe eksport të produkteve ushqimore me origjinë joshgazore mund të

kryhet në Pikën e Inspektimit Kufitar ose në doganën më të afërt të vendit të destinacionit, sipas kërkesës së subjektit. Autoritetet përgjegjëse për

sigurinë ushqimore të secilës palë do ta lejojnë importin dhe eksportin, shoqëruar me certifikata të njohura ose raport-analiza apo dokument

tjetër të përshtatshëm, të lëshuar sipas legjislacionit të secilës palë që garanton sigurinë ushqimore".

Po sipas marrëveshjes, "autoritetet kompetente të secilës palë do ta njoftojnë njëra-tjetrën për planet e kontrollit me bazë risku dhe aktet rregullatore që miratohen në fushën e sigurisë ushqimore. Dhe kontrollet e ngarkesave të ushqimeve me origjinë joshgazore, gjatë importit dhe eksportit, do të realizohen bazuar mbi analiza risku".

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje institucionet respektive të bujqësisë, me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë ushqimore, do të shkëmbejnë publikime profesionale dhe organizojnë trajnime të përbashkëta.

## Zbulohet një sasi e madhe e armatimit në Zveçan

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Policia e Kosovës ka zhvilluar bastisje në lagjen "Gvozden" në Zveçan këtë të martë, ku ka gjetur dhe konfiskuar një sasi të armatimit. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se për dy dekada veriu i Kosovës ka jetuar në ilegalitet, në një rend anormal, ku kanë gjetur strehë organizatat kriminale dhe kriminelët e financuar nga Beogradi. "Kontrabandimi, hyrja ilegalisht e mallrave e armëve në Kosovë, ka prodhuar situatë shqetësuese edhe për

qytetarët tanë në veri, të cilët, të përballur me fuqinë e kriminelëve, kanë jetuar nën shantazh e presion të vazhdueshëm. Si qeveri gjatë dy viteve të fundit kemi zbuluar e bllokuar rrugët ilegale të kontrabandimit. Ditën e sotme Policia e Kosovës, së bashku me institucionet e inteligjencës, pas identifikimit, ka zhvilluar bastisje në një bazë të armatimit në veri të Kosovës, konkretisht në Zveçan. Kjo shtëpi është përdorur për grumbullim dhe shpërndarje të

armatimit për grupet kriminale serbe", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

Ai ka theksuar se deri më tani është zbuluar një sasi e madhe e armatimit, duke përfshirë armë automatike, fishekë, granata dore dhe eksploziv. "Në vendin e ngjarjes, përveç institucioneve të sigurisë, kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të KFOR-it. Veriu hap pas hapi po shkon drejt normalitetit. Rendi dhe ligji nuk do të cenohen në asnjë cep të republikës", ka thënë Sveçla.



## Përfundon hartimi i Udhëzimit Administrativ për largimin e kryetarëve në veri



PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përfunduar hartimin e Udhëzimit Administrativ për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarit të komunës nga funksioni. "Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përfunduar hartimin e Udhëzimit Administrativ për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarit të komunës nga funksioni. Udhëzimi ka për qëllim përcaktimin e procedurës së inicimit,

organizimit dhe dorëzimit të iniciativës së qytetarëve për largimin e kryetarit të komunës nga funksioni, në pajtim me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se pjesë e diskutimeve, punës dhe konsultimeve profesionale dhe e grupit punues kanë qenë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. "Për këtë çështje, marrë parasysh që

është hera e parë që trajtohet me rregullim normativ, ka pasur shumë komente dhe sugjerime. Të gjitha janë trajtuar dhe pjesa më përmbytësore është adresuar. Ky udhëzim jep mundësinë e zbatimit praktik të një të drejte të garantuar nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale. E drejtë kjo që siguron ushtrimin e vullnetit qytetar në raport me kryetarin e komunës, të cilin e zgjedhin drejtpërdrejt qytetarët", ka shkruar Krasniqi.

## Kurti takohet me pensioniste të Prishtinës: Pensionistët kanë bërë shumë për këtë shoqëri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Nën organizimin e Grave për Vetëvendosje, kryeministri Albin Kurti mori pjesë në një bashkëbisedim me gratë pensioniste nga komuna e Prishtinës. Ai tregoi se biseda me gra të kësaj moshe që e kanë njohjen, përvojën, mbi të gjitha dashurinë për vendin, është gjithnjë mësim për secilin prej nesh. "Trajtuam shumë çështje që nga brengat rreth reformës së skemës pensionale deri te nevoja për pensione më të larta. Padyshim gatishmëria

që kemi treguar, duke ndihmuar këtë kategori në përballje me inflacionin dhe vendimi që të mos e lëmë asnjë pension nën 100 euro, ishin vendime që u vlerësuan nga secila prej grave pensioniste. Bashkëbiseduam edhe për punët e tjera që kemi bërë për këtë gjysmëmandati për këtë kategori, e cila asnjëherë nuk është trajtuar sistematikisht e ashtu siç duhet: Mbi 280 mijë pensionistë kanë përfituar tri herë shtesa nga 100 euro, në nëntor 2021, prill 2022 dhe tetor 2022", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ai ka thënë se si qeveri



miratuan ndryshimet në ligj për t'u mundësuar pensionistëve që janë larguar nga puna në vitet '90 të përfitojnë nga pensionet kontributpaguese,

nga e cila nismë përfitojnë rreth 70 mijë pensionistë/e. "Vizita në shtëpi për pensionistët që janë mbi 80 vjeç apo që për shkaqe shëndetësore nuk mund të

paraqiten fizikisht në zyrat e pensioneve. Kemi arritur marrëveshje të njohjeve të kontributeve të sigurimeve për efekt pension pleqërie me Shqipërinë, që është vënë në zbatim për qytetarët në Shqipëri e Kosovë. Së bashku me gratë pensioniste u pajtuam që reforma pensionale duhet të bëhet mbi parimin e gjithëpërfshirjes dhe drejtësisë. Ato që sot janë pensioniste kanë bërë shumë për këtë shoqëri, dhe tash ne si qeveri dhe si shoqëri duhet të bëjmë më shumë për to në mënyrë që secila të ketë mirëqenie dhe jetë të mirë", ka shkruar Kurti.

## Vazhdojnë radhët e pritjes për blerje të teksteve shkollore

Edhe pse janë mbajtur tri ditë mësimi në shkolla të nivelit parauniversitar, radhët për blerje të teksteve shkollore janë të gjata, prej 15 deri në 45 prindër që presin, për dallim nga viti i kaluar kur po kjo qeveri dhe po kjo ministri kishin shpërndarë tekste shkollore falas sipas standardeve të qeverive paraprahe që ishin, edhe më efikase, edhe më pak të kushtueshme

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Monitorues të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) kanë monitoruar disa pika ku qytetarët po i blejnë tekstet shkollore të subvencionuara nga MASHTI sikur që kanë pranuar informata me telefon nga prindërit. "Ndonëse jemi më 5 shtator 2023, që nënkupton se janë mbajtur tri ditë mësimi në shkolla të nivelit parauniversitar, radhët për blerje të teksteve shkollore janë të gjata, prej 15 deri në 45 prindër që presin, në çastin e monitorimit, për dallim nga viti i kaluar kur po kjo qeveri dhe po kjo ministri kishin shpërndarë tekste shkollore falas sipas standardeve të qeverive paraprahe që ishin, edhe më efikase, edhe më pak të kushtueshme", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së, duke theksuar se nëse kemi parasysh faktin se shumë prindër janë të

punësuar, ata duhet të marrin ditë të lirë në mënyrë që t'i blejnë librat ose, edhe më keq, gjyshet apo gjyshërit e nipave dhe mbesave detyrohen të presin në radhë për blerje të librave. "Opozita thiri një mbledhje të jashtëzakonshme pikërisht për këtë situatë të krijuar me tekste shkollore të cilën e cilësuan si dështim mirëpo pozita e shpërfilli këtë seancë të jashtëzakonshme duke injoruar kërkesën e deputetëve të opozitës sikur edhe duke e relativizuar gjendjen e krijuar", thuhet në komunikatë. Sipas KMDLNj-së, reagimi i Këshillit të Prindërve do të duhej të ishte shumë më i vendosur aq më parë që mungesa e teksteve shkollore pengon mbarëvajtjen e mësimi, fëmijëve të tyre. "Natyrisht se SBASH-u nuk ka reaguar sepse nuk e konsideron se është pjesë e mandatit për faktin se mbron interesat e arsimtarëve e jo të nxënësve ndonëse kjo mungesë ndërlihet dhe ua vështirëson punën të

gjithë mësimdhënësve të angazhuar në procesin mësimor. KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon që rasti të hetohet nëse kjo mënyrë e pajisjes me tekste shkollore ka ruajtur mjete të buxhetit të Kosovës apo e ka dëmtuar buxhetin dhe pas kësaj të përcaktohet përgjegjësia e mundshme institucionale, profesionale dhe ligjore. Për KMDLNj-në mbetet i paqartë fakti pse MASHTI shmangu mënyrën e shpërndarjes së teksteve shkollore nëse vitin e kaluar ishte e vlerësuar si e suksesshme kur, në ndërkohë ishte dhe mbeti e njëjta përmbajtje edhe e qeverisë sikur edhe e MASHTI-t, i njëjti kryeministër dhe e njëjta ministër. Është e pabesueshme se si pas gjithë kësaj tollvie askush nuk flet për përgjegjësi (nga radhët e pozitës) ndonëse flitet se janë ndarë më shumë mjete se që ishin ndarë në vitin paraparak, ndërsa efikasiteti ka rënë për tokë", theksohet në komunikatën e KMDLNj-së.



## Profesorë dhe studentë nga Universiteti Charles i Çekisë vizitojnë UP-në

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Arta Basha-Jakupi, prorektore për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, së bashku me profesorin Arsim Ejupi dhe zyrtarë nga Zyra për Marrëdhënie me Jashtë, kanë pritur profesorët dhe studentët nga Universiteti Charles në Republikën Çeke. Në kuadër të vizitës nga Universiteti Charles ishin profesorët Josef Novotny, Martin Lepic, Jiri Hasman dhe 20 studentë nga ky universitet. Në mirëseardhjen e profesorëve

dhe studentëve, prorektorja Basha-Jakupi vlerësoi vizitën e tyre në Universitetin e Prishtinës dhe mundësitë e bashkëpunimit të ardhshëm me Universitetin Charles në kuadër të ndërkombëtarizimit të Universitetit të Prishtinës. Prorektorja nënvizoi rëndësinë e dimensionit ndërkombëtar, duke theksuar se studentët dhe profesorët të shumtë nga Kosova kanë ndjekur mundësitë e arsimimit jashtë vendit, duke pasuruar peizazhin akademik të universitetit. Prorektorja Basha-Jakupi



theksoi edhe programet e shumta në gjuhën angleze që ofrohen në Universitetin e

Prishtinës, si semestrat e shkëmbimit dhe Universiteti Veror i Prishtinës, vazhdojnë të

sjellin studentë nga e gjithë bota. Profesorët e Universitetit të Charles shprehën interesimin e tyre për ta vizituar Kosovën, veçanërisht Universitetin e Prishtinës, bazuar në aspekte të ndryshme gjeografike, historike dhe kulturore që përcakton këtë rajon. Gjatë vizitës së tyre studentët nga Universiteti Charles në Republikën Çeke ndanë përvojat e tyre në Kosovë, duke vlerësuar ngrohtësinë e popullit të saj dhe pasurinë e kulturës së saj.

## Pse rritja e të hyrave në shtet s'është lajm edhe aq i mirë?

**PRISHTINË, 5 SHTATOR** - Dy institucionet e Kosovës nga të cilat varet mbushja e arkës së shtetit - Dogana dhe Administrata Tatimore - kanë shënuar rritje të të hyrave në muajt e deritashëm të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Deri më 22 gusht Dogana ka arritur të mbledhë një miliard euro, duke tejkaluar shumën e vitit të kaluar për 71 milionë euro.

Ngjashëm edhe Administrata Tatimore - ka grumbulluar 515 milionë euro, apo 79 milionë më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Për ushtruesin e detyrës së drejtorit ekzekutiv të ATK-së, Ilir Murtezaj, janë disa faktorë që kanë ndikuar në rritjen e të hyrave tatimore. "Rritja e llogaridhënies, e përgjegjësisë së stafit, pastaj kampanjat e shumta me të cilat po i bëjmë thirrje komunitetit të biznesit që t'i përmbushë detyrimet tatimore, si dhe automatizimi i shumë proceseve të punës", veçon Murtezaj për "Radion Evropa e Lirë".

Për njohësit e çështjeve ekonomike ky nuk është ndër lajmet më të mira.

Buxheti i shtetit, sipas tyre, do të ishte më i qëndrueshëm sikur të mbushej nga sektori i prodhimit. "Nëse Kosova ka nivel më të lartë të prodhimit vendor, kjo e shumëfishon qarkullimin e mjeteve brenda tregut të Kosovës - qoftë të parave që vijnë nga diaspora, qoftë të atyre të krijuara nga pagat në Kosovë", thotë për "Radion Evropa e Lirë",

Muhamet Mustafa, profesor i shkencave ekonomike në Prishtinë. "Nëse importojmë gjithçka nga jashtë - qoftë ushqime apo komponentë për ndërtimin e banesave - ky efekt shkon në vendet prej ku importojmë, nuk mbetet në Kosovë", thotë ai.

Kosova prej vitesh përballet me deficit të lartë tregtar, që do të thotë se importon më shumë sesa eksporton, përkundër zotimeve të autoriteteve se do ta forcojnë sektorin e prodhimit.

Me reforma ekonomike, thotë Nagip Skenderi, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, bizneset në Kosovë vazhdojnë të përballen me probleme të shumta, që i pengojnë të jenë konkurrenca në tregjet ndërkombëtare. Ai përmend këtu: tatimet e larta mbi vlerën e shtuar, normat e larta të interesit për kredi, konkurrencën e pabarabartë e të tjera. "Kompanitë që arrijnë të eksportojnë duhet të favorizohen, të mos paguajnë taksa doganore dhe të kenë një çmim konkurrues në tregun ndërkombëtar. Fuqizimi i industrisë prodhuese është bazë për rritje të buxhetit", thotë Skenderi për "Radion Evropa e Lirë".

Në këtë frymë u deklarua më herët për REL-in edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. Në bazë të informacioneve që ka, ai tha se bizneset në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe disa vende të tjera në rajon kanë politika më të mira fiskale dhe subvencionohen nga shteti. "Energjia elektrike për



prodhuesin në Kosovë nuk është e subvencionuar, ndërsa në vende të tjera kanë lehtësira. Në disa vende prodhuesit janë të liruar edhe nga tatimet për ambalazhe, ndërsa në Kosovë nuk janë", tha Rafuna.

Kosova importon shumicën e produkteve - nga mielli deri te materiali ndërtimor - prej shteteve fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian. Kjo, me gjithë faktin se, sipas të dhënave zyrtare, ka rreth 2 400 kompani prodhuese.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për muajin korrik tregojnë se, në krahasim me korrikun e vitit të kaluar, vlera e importit është rritur, ndërsa ajo e eksportit ka rënë. Sipas tyre, vendi importoi mallra në vlerë prej 512 milionë eurosh në korrik, apo 10 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të 2022-s.

Vlera e eksportit, ndërkaq, ishte 67 milionë euro, apo 9 milionë euro më pak se një vit më parë. Nga llogaritja e shifrave të Bankës Qendrore të Kosovës në pesë vjetët e fundit, del se vlera e mallrave të importuara ka arritur në dhjetëra miliarda euro.

Në programin katërvjeçar të Qeverisë së Kosovës qëndron zotimi për orientimin e ekonomisë kah prodhimi dhe eksporti. "Qeveria do t'i mbështesë bizneset në blerjen e makinerisë prodhuese dhe përpunuese, duke synuar digjitalizimin e procesit të përpunimit dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe prodhuese", thuhet në program. Në korrik, Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë e Kosovës ofroi përkrahje financiare, në vlerë prej një milion eurosh, për blerjen e

makinae prodhuese dhe përpunuese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme prodhuese. Qëllimi i përkrahjes së këtyre bizneseve u tha se është rritja e investimeve, rritja e konkurrencës dhe hapja e vendeve të reja të punës.

Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 - dokument mbi bazën e të cilit hartohet buxheti - thuhet, po ashtu, se industria e prodhimit do të jetë prioritet. "Prioritetet e qeverisë për periudhën e ardhshme trevjeçare do të fokusohen në riorientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjes së punësimit të dinjitetshëm për të gjithë...", thuhet, mes tjerash, në dokument.

Sipas parashikimeve në të, buxheti i shtetit për vitin 2024 do të jetë 3.2 miliardë euro, aq sa është edhe këtë vit.

## Oda Amerikane kërkon heqjen e masave për importet nga Serbia

**PRISHTINË, 5 SHTATOR** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës t'i heqë masat për importet nga Serbia pasi, sipas kësaj organizate ekonomike, një vendim i tillë po prek edhe importet nga kompanitë në pronësi amerikane.

Më 15 qershor, pasi forcat serbe arrestuan tre policë të Kosovës, Qeveria e Kosovës ndaloi pothuajse të gjitha importet nga Serbia. Policët më pas u liruan, por ekzekutivi i Kosovës mbajti në fuqi ndalesën për importet. Sipas OEAK-ut, ky vendim ka bërë që importet nga kompanitë në pronësi amerikane të bien për më shumë se 39 për qind krahasuar me vitin paraprak, duke shtuar se importet e lidhura me kompanitë amerikane po pakësohen "me një rritëm alarmues". "Ndalimi, i cili synon Serbinë



dhe produktet e importuara nga ky shtet, në fakt ndikon në masë të madhe në kompanitë ndërkombëtare. Shumë prej këtyre bizneseve janë në pronësi të kompanive nga shtetet partnere, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë qenë shtylla kyçe në mbështetjen e

trajktoreve të rritjes së Kosovës", u tha në një njoftim për medie të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Doganat e Kosovës kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se kanë rënë importet nga Serbia. Sipas të dhënave, në qershor dhe korrik të këtij viti vlera e

importeve serbe ishte afër 20 milionë euro, apo mbi 50 milionë euro më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. "Radio Evropa e Lirë" raportoi më 2 shtator se importet nga Serbia po zëvendësohen me mallra nga shtetet e tjera, kryesisht nga Maqedonia e Veriut.

OEAK-u tha se edhe në të kaluarën i ka kundërshtuar barrierat tregtare nga Kosova për importet e shteteve fqinje. "Marrëdhëniet e mira fqinjësore janë parakusht kryesor për integrimin euroatlantik të Kosovës. Masat aktuale, për fat të keq, janë në kundërshtim me thirrjet e aleatëve ndërkombëtarë të Kosovës, të cilët bëjnë thirrje për marrëdhënie harmonike rajonale. Prandaj, Oda Amerikane thekson se normalizimi ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i kapërcen interesat bilaterale. Është një strategji thelbësore për çimentimin e stabilitetit rajonal dhe për t'i çuar përpara ambiciet e integritimit evropian", u tha në njoftim. Mesatarisht në vit Kosova importon mallra nga vende të ndryshme të botës në vlerë prej 5 miliardë eurosh, ndërsa eksporton vlerën e më pak se 1 miliard eurove.



# Kongresi i 10-të i Partisë së Punës së Shqipërisë kishte përfaqësues edhe nga Kosova



Faton B. MEHMETAJ

Partia e Punës e Shqipërisë ishte pasardhëse e Partisë Komuniste të Shqipërisë që ishte njëkohësisht edhe partia udhëheqëse e Shqipërisë nga vitet 1948-1991, si dhe e vetmja parti e ligjshme. Partia Komuniste e Shqipërisë u themelua me këtë emërtim më 8 nëntor të vitit 1941 me bashkimin e grupeve komuniste të cilët deri në atë kohë luftonin të veçuar nga njëri-tjetri. Siç dihet njëri prej iniciatorëve të koordinimit për bashkimin e grupeve komuniste në Shqipëri ishte malazezi Miladin Popoviqi i cili është vlerësuar si personalitet pro shqiptar nga një grup i historianëve të Kosovës dhe Shqipërisë, por ka edhe mjaft historian në Kosovë dhe Shqipëri që figurën e Milladin Popoviqit e qesin si figurë kontroverze dhe që i ka tradhtar interesat shqiptar. Milladini ishte përkrahësi i Enverit dhe i vetmi jugosllav që i besoi kreu komunist shqiptar edhe pse ishte ndër iniciatorët kryesor të prishjes së marrëveshjes së Mukjës, por edhe i rezultateve të konferencës së Bujanit, i ndihmuar nga Titoja dhe Rankoviqi dhe nga rrjeti i komunistëve shqiptarë që kishin orientim pro-jugosllav e kishin lënë Kosovën për herë të dytë jashtë kufijve të Shqipërisë, akt ky që u cilësua nga strukturat përparimtare të kohës si tradhti kombëtare. Kjo ishte arsyeja pse u vra Milladin Popoviqi më 13 mars të vitit 1945 në Prishtinë nga Haki Taha person me ndikim tek krerët e organizatave dhe grupeve që nuk ishin të kënaqura me veprimtarinë e Partisë Komuniste në Shqipëri dhe Kosovë të cilët e kishin përanditur planin në bashkëpunim me Aleksandër Rankoviqin, Dushan Mugoshën, Spasoje Gjakoviqin, Svetozar Markoviq-Tempon, Milladin Popoviqin, Millovan Gjillasi, Petar Brajeviqin etj, që Kosva të mbetet nënë Serbi e Shqipëria të bëhet njësi e 7 e Federatës Jugosllave. Sidoqoftë Partisë Komuniste të

Shqipërisë për pjesën më të madhe të ekzistencës së saj, ishte e dominuar nga Sekretari i saj i Parë, Enver Hoxha, i cili ishte edhe drejtuesi de fakto i Shqipërisë dhe sundoj për 45 vite në Shqipëri. Emri iu ndryshua nga PKSH-ja në PPSH më 1948 në Kongresin e I-rë, ndërsa pas 1991 në Kongresin e X të PPSH i mbajtur në qershor 1991 u vendos ndryshimi i emrit nga PPSH në Parti Socialiste (PS). Nga disa, Kongresi i 10-të është quajtur kongresi i rinovimit. Sekretari i parë i PPSH, Ramiz Alia, dha dorëheqje nga ky post pasi u zgjodh president i vendit në zgjedhjet e 31 marsit. Pas përfundimit të Kongresit të 10-të dhe ndryshimit të emrit në Parti Socialiste, në Shqipëri filloj të lindë një forcë e re politike.

## Rrethanat politiko-shoqërore para se të mbahej Kongresi i 10-të i PPSH-së

Rrethanat politiko shoqërore para se të mbahej Kongresi i 10-



Ftesa për pjesëmarrje në Kongresin e 10-të të PPSH-së

të i PPSH-së ishin shumë të ndërlikuara jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon. Në shumë vende të bllokut komunist dhe në Evropën Lindore, vëreheshin shenjat e rënjes së sistemit komunist në këto vende. Muri i Berlinit

kishte rënë. Poashtu në këtë kohë Nikolla Çausheku, presidenti i Rumanisë u ekzekutua gjatë protestave të Revolucionit në Ruman të vitit 1989. Kudo kishte trazira. Ekonomia kishte rënë gati në pikën zero. Si kudo në këto vende edhe në Shqipëri rënia e komunizmit filloi në dhjetor të vitit 1990. Madje qysh në vitin 1989 në Shkodër kishin filluar revoltat e para qytetare, turmat në protesta e shkatërruan statujën e Stalinit. Protestat u përhapën edhe në qytete të tjera të Shqipërisë si në; Tiranë, Kavajë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë etj. Më 20 shkurt 1991 protestuesit rrëzuan bustin e Enver Hoxhës. Në vitin 1998 Shqipëria ratifikoi kushtetutën e parë post-komuniste. Pastaj Ramiz Alia firmosi Marrëveshjen e Helsinkit që e detyronte shtetin shqiptar të respektonte të drejtat e njeriut, të cilat ishin shpërfillur totalisht gjatë diktaturës komuniste. Me 2 korrik 1990, me mijëra të rinj u futën në ambasadat perëndimore, për të fituar strehim politik për një jetë më të mirë. Pas kësaj mbi 20.000 shqiptarë u larguan përmes mjeteve ujore dhe ky ishte emigrimi masiv më i madh i shqiptarëve që njëhënjë në shumë periudha historike. Policia kufitare vret shumë të rinj shqiptarë që po arratiseshin drejt perëndimit. Edhe pas protestave dhe rebelimeve të shumta, mbahen zgjedhjet e para pluraliste me 31 mars të vitit 1991 ku Ramiz Alia dhe partia komuniste me shumë manipulime sërish zgjedhet,

sepse Kodi Zgjedhor dukshëm favorizonte PPSH. Në dhjetor të vitit 1990, Ramiz Alia nën presionin e studentëve u detyrua të lejonte krijimin e forcave politike të pavarura, duke shënjuar kështu fundin e monopolit të Partisë Komuniste. Në fillim të dhjetorit të vitit 1990 Studentët e Universitetit të Tiranës formuan Partinë Demokratike të Shqipërisë, e para parti opozitare pas afro 50 vitesh. Për qudi, udhëheqësi kryesorë i kësaj partie ishte Sali Berisha i cili në periudhën e komunizmit një kohë ishte si sekretar i Partisë komuniste por që pas rënies së komunizmit u printe reformave dhe idesë së përhapjes së pluralizmit politik, pastaj Azem Hajdari, Genc Pollo, Aleksandër Meksi, Gramoz Pashko etj. Partia e re bazohet mbi idealet e "Demokracisë, Lirisë, Pluralizmit dhe Tregut të Lirë". Sikurse në Shqipëri vala e ndryshimeve kishte përfshirë edhe Kosovën. Masat e gjëra duke përfshirë edhe udhëheqës të lartë politik të kohës i dorëzuan librezat komuniste të partisë (libreza këto që për shumë kë ishin të barasvlershme me karrierë por edhe me jetën e tyre), me 2 shkurt 1990 me nismën e Anton Çetës nisi në Kosovë aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve që mori përmasa të gjëra, duke u përhapur anembanë vendit. Pajtimi i Gjaqeve në Kosovë konsiderohet si një prej periudhave më të bardha të historisë shqiptare. Hasmëritë disavjeçare morën fund.

Të njihet sovraniteti i Kuvendit të Kosovës dhe akti i shpalljes së Kosovës Republikë

KËRKESË DREJTUAR KUVENDIT POPULLOR

Të nderuar deputetë,  
2 korriku i këtij viti shënon përvjetorin e parë të ngjarjes më të rëndësishme historike kombëtare të këtij gjysmë shekulli, shpalljen e Republikës së Kosovës dhe miratimin e Kushtetutës së saj nga Kuvendi i Kaçanikut. Mbarë opinioni shqiptar, organizata e parti politike brenda dhe jashtë kufijve, mjaft autoritete politike e shtetërore jugosllave e gjetkë, me anë rezolutash e deklaratah e kanë konsideruar të ligjshëm këtë akt sovran të Kuvendit të Kosovës dhe kanë kundërshtuar me forcë dhunën antishqiptare dhe vendimet antikushtetuese të shovinistëve serbë.  
Është në nderin dhe detyrën e Kuvendit Popullor të RSH-së, me rastin e këtij përvjetori dhe në rrethanat kur po përcaktohet ardhmëria e Jugosllavisë, të njohë zyrtarisht sovranitetin e Kuvendit të Kosovës dhe të aktit të Shpalljes së Kosovës Republikë, duke konfirmuar të drejtën e kombeve, gofshin këta edhe të vegjël, për vetëvendosje. Ky veprim do t'i tregojë shumë opinionit demokratik botëror, shtetëve dhe organizatave ndërkombëtare se RSH dhe shteti shqiptar respekton frymën e Kartës së OKB-së dhe të dokumenteve themelore të KSBE-së. Ai do të shërbejë edhe si mbështetje e fuqishme dhe e gjithanshme për vëllëzërit tanë që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi në luftën e pabarabartë që ata bëjnë kundër nëpërkëmbjes së të drejtave të tyre njerëzore dhe kombëtare.  
Kuvendi Popullor të formulojë edhe të gjitha kërkesat që rrjedhin nga njohja e Republikës së Kosovës.  
1. Të largohen menjëherë repartet e dhunës, ushtria e milicia serbe nga Republika e Kosovës.  
2. Të kthehen në punë të gjithë punëtorët e përjashtuar padrejtësisht.  
3. Të rifillojë punën gazeta "Rilindja", radiotelevizioni në gjuhën shqipe dhe të ndalohet çdo represion ndaj punonjësve të tyre.  
4. Të lirohen të gjithë të burgosurit politikë të ndërgjegjes.  
5. Të mbyllën të gjitha dosjet hetimore dhe proceset e hapura për arsye politike.  
6. Të sqarohen të gjitha rastet e vrasjeve të ushtarakëve shqiptarë në njësitet Jugosllave. T'u jepet fund krimeve të tilla.  
7. T'u jepet fund ndjekjes së mesuesve, pedagogëve, nxënësve, shqiptarë, intelektualëve të shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi.  
8. Të kthehet në punë Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e saj dhe Presidenca e Republikës.  
9. Republika e Kosovës të jetë e barabartë në bisedimet mes republikave për të ardhmen e Jugosllavisë, rikonstruktimit e federatës ose shpërbërjen e saj.  
Kuvendi Popullor përtë zbatuar deri më një detyrim që rrjedhin nga njohja e Republikës së Kosovës të miratojë aktet e nevojshme dhe përgjegjësitë përkatëse në Qeveri, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve, Ministrinë e Lidhjeve Ekonomike me Jashtë, Ambasadat tona etj., për të sensibilizuar më tej opinionin botëror, për të përkrahur konkretisht çështjen e Republikës së Kosovës dhe të shiptarëve në Jugosllavi, për zhdukjen e çdo muri të "Berlinit" mes dy pjesëve të kombit.  
Nga 324 intelektualë të Tiranës dhe të disa rrethëve: vijojnë emrat dhe firmat e tyre.  
" Bashkimi " OQPPSH-së Nr. 140 (13186) F. 1. 22. Qershor 1991

Kërkesa e mbi 324 intelektualëve të Tiranës dhe të disa rrethëve drejtuar Kuvendit Popullor për njohjen e sovranitetit të Kuvendit të Kosovës

Tubimi në Verrat e Llukës do të mbetet si momenti i bashkimit më të madh të shqiptarëve të Kosovës. Ky konsiderohet edhe si viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar që hyri në histori si vit i bashkimit e i pajtimit të popullit shqiptar kudo që jetonte, brenda trojeve etnike dhe mërgatë. Vëreheshin filet e shpërbërjes së Jugosllavisë. Grupet e rinisë së bashku me patriotët shqiptarë që kishin punuar me breza kundër Jugosllavisë përgatiteshin për ta goditur sistemin e Millosheviqit i cili bënte zullum në popujt e Jugosllavisë e veçanërisht në Kosovë.

Intelegjenca përparimtare e Kosovës kishte përpiluar platformën e cila qëllim të vetëm parashihte progresin e Atdheut. Në vitin 1991 Forumi Rinor i Deçanit apeloj publikisht për bojkotimin e Armatës Jugosllave, apeli mori përmasa në gjithë Kosovën dhe rinia e bojkotoj shkuarjen në Ushtrinë e asaj kohe. Në pranverën e vitit 1990 Serbia përdori gazrat toksike për helmimin e të rinjve shqiptarë në Kosovë, helme këto që rezultuan të jenë veprime të kryera në kuadër të një doktrine për shfarosjen e shqiptarëve, e përgaditur dhe zbatuar nga shërbimi sekret ushtarak serb. Në vitin 1991 Kosova qeverisë nga dy qeveri paralele, nga Qeveria pushtuese, që mbështetej në ushtri e polici, e cila i kishte uzurpuar edhe ndërtesat publike, mblidhte taksa, plaçkiste e çka nuk bënte mbi popullin shqiptar, dhe qeveria tjetër që ishte zgjedhur nga populli i Republikës së Kosovës, e cila dha kontribut në ruajtjen e kontinuitetit dhe unifikimit të popullit deri në fitore të plotë, me 2 korrik 1990, ku delegatët e Kuvendit miratuan publikisht

Deklaratën Kushtetuese, me anë të së cilës Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave. Në këtë periudhë Kosova ndodhej në një fazë të re, nga institucionet e pushtetit shtetëror të Kosovës, kërkohesh njohja e pavarësisë, ndërsa nga faktori ndërkombëtar kërkohesh që të bisedohej për status. Po ashtu në vitin 1991 Kosova shpalli referendumin për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur. Referendumi vërtetoi dhe legjitimoi Deklaratën e 2 korrikut 1990 dhe shpalljen e pavarësisë së 7 shtatorit 1990. Rreth 90% e qytetarëve të Kosovës votuan "Për" Kosovën shtet të pavarur. Në këto rrethana politiko-shoqërore që ishin krijuar në atë kohë, u bë e qartë se liria do të sigurohej vetëm me luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës. Jugosllavia kishte filluar të



*Faton B. Mehmetaj dhe Isuf B. Bajrami në Kongresin e 10-të të PPSH-së*

shpërbëhet si rezultat i trazirave dhe konflikteve politike gjatë fillimit të viteve 1980 që zgjaten deri në shkatërrimin e Jugosllavisë. Në vitin 1987, Sllobodan Millosheviçi erdhi në pushtet në Serbi, dhe përmes një sërë lëvizjesh populiste, duke e përdorur aparatën shtetërore që shkaktoj dhunë e terror, mori kontrollin de facto mbi Kosovën, Vojvodinën dhe Malin e Zi, duke fituar mbështetjen e serbëve dhe pak të popullatës jo serbe nga këto vende për zbatimin e politikave të tij qendrore, me qëllim që t'i mbërrinte politikën e tij për ta zbatuar projektin e Serbisë së Madhe (të gjithë serbët duhet të jetojnë në një territor). Republikat përbërëse të Jugosllavisë u ndanë në mes të shpërthimit të Luftërave Jugosllave, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi formuan Republikën Federale të Jugosllavisë. Millosheviqi luajti një rol të madh në luftëra, dhe në emër të serbëve të Bosnjës negocioi Marrëveshjen e Dejtonit, e cila i dha fund Luftës së Bosnjës në vitin 1995. Gjatë mbretërimit të tij u zhvilluan protesta të shumta kundër qeverisë dhe kundër luftës, ndërsa vlerësohet gjithashtu se ndërmjet 50.000 dhe 200.000 njerëz dezertuan nga Ushtria Popullore Jugosllave e kontrolluar nga Millosheviqi, dhe se midis 100.000 dhe 150.000 njerëz emigruan nga Serbia, duke refuzuar të

marrin pjesë në luftëra. Në atë periudhë Millosheviçi u atakua (përplas) me opozitën dhe krerët e partive të republikave të Sllovenisë dhe Kroacisë, të cilat kishin orientim perëndimor. Ata e mbështetën demokratizimin e vendit në përputhje me parimet e Revolucionit të vitit 1989 që ndodhën në Evropën Lindore. Kjo ndodhi që Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë të shpërndahet në janar të vitit 1990 përgjatë vijave federale. Organizatat komuniste republikane u shndërruan në partitë të ndara socialiste. Në këtë kohë kudo kishte trazira, më 28 mars të vitit 1989, organet e sigurimit shtetëror të asaj kohe shqiptaro-serbe kidnapuan mbi 200 shqiptar, intelektual dhe figura eminente të Kosovës. Askush nuk dinte për fatin e tyre, më vonë u mur vesh se ata i kanë dërguar në izolim në burgun e Leskovcit, të Vranjës, Zajeçarit etj. Në këtë kohë ishte vendosur edhe gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë. Intelektualët e Kosovës nënshkruan apelin e 215 intelektualëve kosovar si, reagim ndaj rrezikut të rrënimit të Autonomisë së Kosovës. Keqësimi i gjendjes në ish-Jugosllavi më 1991 reflektoj shumë edhe në Kosovë. Për tetë ditë, nga 28 shkurt 1989, mbi 1300 minatorë grevistë të Trepçës, Xeherores së Stantërgut u futën në grevë në horizontin e tetë, rreth një mijë metra nën

tokë. Kjo grevë mori përmasa të mëdha politike, e cila ato ditë u shndërrua në një lëvizje që e zgjoj gjithë popullin në këmbë duke ja dridh themelet Jugosllavisë. Po ashtu në vitin 1991 nga një grup intelektualësh të lartë nga Shqipëria dhe Kosova e dhanë idenë për pajtim kombëtar. Në mbështetje të Kosovës ka fundi i qershorit 1991 mbi 400 intelektual nga Tirana dhe rrethet tjera e kishin bërë një kërkesë drejtuar Kuvendit Popullor përmes një peticioni që të njihet sovraniteti i Kuvendit të Kosovës dhe akti i Shpalljes së Republikës së Kosovës.

Pas një periudhe krizash politike në këto vite, republikat përbërëse të; Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë u ndanë, por çështjet e pazgjidhura shkaktuan luftëra të hidhura ndër-etnike në territorin e Jugosllavisë. Luftërat kryesisht prekën Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kroacinë. Midis qershorit 1991 dhe prillit të vitit 1992, katër republika shpallën pavarësinë e tyre (vetëm Serbia dhe Mali i Zi mbetën në Konfederatën Serbi-Mali i Zi, e që më vonë edhe Mali i Zi do të ndahet nga Serbia, duke e shpallur pavarësinë si shtet më vehte). Edhe pas kësaj statusi i serbëve etnikë jashtë Serbisë, Malit të Zi dhe kroatëve etnikë jashtë Kroacisë, mbetën të pazgjidhura. Sikurse republikat tjera, edhe Kosova u

pavarësua me luftë të armatosur nënë udhëheqjen e UÇK-së. Në mungesë të një strategjie dhe të unifikimit të spektrit politik kosovarë, Kosova edhe pse e pavarësuar në vitin 2008, ende ka probleme rreth definimit të statusit dhe shumë çështjeve midis Kosovës dhe Serbisë, të cilat po mbahen si çështje aktuale përmes dialogut dhe bisedimeve Kosovë-Serbi.

### **Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në Kongresin e 10-të të PPSH-së**

Në Kongresin e 10-të të Partisë së Punës së Shqipërisë që u mbajtur në qershor 1991 ku edhe u vendos ndryshimi i emrit nga PPSH në Parti Socialiste (PS), vendim ky që i hapi rrugën, një epoke të re ku në Shqipëri filloj të lindë një forcë e re politike.

Në Kongresin e 10-të nga Kosova morën pjesë: Faton Bajram Mehmetaj nga Pozhari i Deçanit dhe Isuf Bali Bajrami nga Velekinca e Gjilanit me vendbanim të përhershëm në Gjilan, udhëtuam nga Gjilani, pikërisht nga familja e Xhevat Sahitit për në Stubëll të Rekës së Keqe, fshat afër kufirit me Shqipërinë. Aty jemi ndalë në familjen e Xhevdet Sadrisë i cili po ashtu ishte pjesëtar i ilegales dhe ishim në kontakt më të edhe më herët. Xhevdeti na ka përcjellë deri në kufi së bashku më Isuf Adem Sadrinë

po ashtu nga Stublla, madje shumë në brendi të territorit të Shqipërisë dhe kemi vazhduar së bashku me Isuf Bajramin deri në Tropojë ku kemi qëndruar një natë dhe të nesërmen nga aty kemi udhëtuar për në Bajram Curr. Kur arritëm në Bajram Curr u bashkuam me deputetët e Tropojës, Hasit, Kukësit, Bajram Currit etj, dhe udhëtuaam së bashku me ta për në Tiranë në Kongresin e 10-të të PPSH-së. Kongresi u mbajt më 12 qershor të vitit 1991 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Ishim të pajisur me dokumentacione përkatëse, leje qëndrimi, ftesa për të marrë pjesë në Kongres dhe ishin marrë masat për sigurinë tonë gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri. Ishim të ftuar zyrtarisht dhe e përfaqësonim Kosovën në këtë Kongres. Edhe para se të mbahej Kongresi ishim në kontakte të përhershme me kreun e shtetit shqiptar, me Ramiz Alinë, Haxhi Lleshin, Shaban Brahen, Sulo Gradecin, Ramazan Mesitin, Gramos Ruçin, Remzi Demajn, Sokol Pezën etj. Fjalën kryesore e mbajti Xhelil Xhoni, kurse drejtues i punimeve të Kongresit ishte Gramoz Ruçi. Gjatë punimeve një pikë më rëndësi e Kongresit ishte ndërrimi i emrit, këtu pati përplasje të mëdha midis deputetëve por pasi që u hodh në votim kaloi propozimi që emri i Partisë së Punës së Shqipërisë të emërohet Partia Socialiste. Kryetar i parë i Partisë Socialiste të Shqipërisë u zgjodh Fatos Nano. Pas tjerëve Dritëro Agolli hodhi kritika të ashpra dhe mjaft të arsyeshme mbi punën shumëvjeçare të Partisë së Punës së Shqipërisë. Për kureshtje, gjatë punimeve të Kongresit në kohën e pauzave e takuam edhe Dritëro Agollin i cili na sugjeroi dhe na dha disa udhëzime mjaft të dobishme se si të veprohet me Kosovën dhe me popullatën shqiptare që kishte mbetur jashtë tringut amë. Në Kongresin e 10-të të PPSH-së me kërkesën tonë të mbështetur edhe nga deputetët e Tropojës, Bajram Currit, Kukësit, Hasit dhe disa personaliteteve me ndikim siç ishin, Sylo Gradeci, Gramoz Ruçin, Sokol Peza, Gjilil Gjoni, Musa Ulqini, Haxhi Lleshit, Zenel Neza deputet i Bajram Currit në Kongresin të 10-të të PPSH-së etj, u miratua Rezoluta për Kosovën, tekstin e kësaj rezolute e lexoi para të pranishmëve Mehmet Elezi. Kongresi e miratoi Rezolutën për Kosovën, që Shqipëria ta njeh Republikën e Kosovës, dhe ti njih të drejta shqiptarëve jashtë tringut amë, si dhe të drejtën e referendumit për tu bashkuar me Shqipërinë. Rezoluta implikonte shtetin shqiptar


dhe ushtrinë shqiptare për ti dalë zot Kosovës në mënyrë të armatosur, në rast lufte apo të ndërhyrjes ushtarake të Serbisë në Kosovë. Rezoluta bëri bujë të madhe.

Rezoluta për Kosovën që ishte miratuar në Kongresin e 10 të PPSH-së, në bazë të së cilës Xhelil Xhoni propozoi një Rezolutë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për njohjen e Republikës së Kosovës dhe Kushtetutën e Kaçanikut. Kjo Rezolutë u miratua në Kuvendë, por më vonë është shfuqizuar pasi ka ardhur Sali Berisha në pushtet! Sali Berisha nuk e ka njohtë rezolutën që është miratuar në Kongresin e 10 të PPSH-së dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë!

Pas përfundimit të punimeve të Kongresit, patëm disa takime me intelektualë si Dr. Razi Brahimi, Dritëro Agollin, etj. Gjatë kthimit për në Kosovë, u vendosëm në banesën e Zenel Nezës në Bajram Curr. Duhet cekur se me familjen e Zenel Nezës kishim miqësi familjare qysh në kohën e Ali Ibrës dhe e kishim vazhduar miqësinë më këtë familje deri në vitet 1987 kur Cyme Mehmetaj ishte martuar me Skënderin djalin e Elez Ali Brahës të familjes Nezaj etj. Aty pushuam dy netë dhe përmes ndihmës që na dha Zenel Neza dhe Halil Haklaj, i cili ishte së bashku me neve në Kongres, ata biseduan me Fatmir Haklaj i cili së bashku me një shoqëruar të vetin na përcjelli deri afër kufirit me Kosovë. Me Fatmir Haklajn dhe Zenel Nezajn kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme deri në fillimin e luftës frontale në Kosovë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve Ramiz Alia i cili në atë kohë ishte president i Shqipërisë, kuptohet duke e pasë për bazë edhe Rezolutën për Kosovën që ishte miratuar në Kongresin e 10-të të PPSH-së, kishte marrë vendim për ti lejuar përgatitjet e grupeve guerile nga Kosova në Shqipëri.

Pas pjesëmarrjes në Kongresin e 10-të të PPSH-së, përmes kontakteve dhe bisedave me disa përfaqësues të veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të Shqipërisë të cilët kishin ndikim të madh për kohën, arritëm ta fitojmë përkrahjen e organizatës së tyre të cilët na mbështetën në mjaft projekte dhe aksione në përkrahje të Kosovës. Për të kaluar në organizimin e armatosur kanë ndikuar shumë faktor, por njëri prej tyre ishte më relevant. Akademikët e Shkencave të Serbisë kishin përpiluar disa memorandume e platforma politike për ta mbajtur nën ombrellën e Serbisë Kosovën dhe viset tjera shqiptare që kishin mbetur




### Rezoluta për Kosovën që u miratua në Kongresin e 10-të të PPSH-së

nënë Jugosllavi. Por Memorandumi i fundit i kësaj akademie, ishte ai i vitit 1986, i cili në të vërtetë përfaqësonte një version të sintetizuar të të gjitha projekteve të mëparshme për spastrimin etnik (përmes krimeve, genocidit e spastrimit etnik) të hapësirave shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Sanxhak, Kosovë Lindore etj, vende këto që kishin mbetur jashtë tringut amë përmes disa vendimeve të fuqive të mëdha që i morën në dëm të shqiptarëve nën trysnin e Ruisë. Ky Memorandum kishte planifikuar që të gjithë Jugosllavinë ta kthente në një ndikimin e Serbisë ashtu siç kishte ndodhur sidomos pas vdekjes së Titos. Akademikët serb u shkolluan në shkollat pansllaviste dhe si të tillë kanë

qenë mjeshtër të dezinformimit, propagandës, dhe të mashtrimit. Institucionet e Akademisë së Serbisë kundër shqiptarëve i vunë në dispozicion të gjitha mjetet duke i përdorur paragjykimet, keqinformimet dhe format tjera bizare për ta bindur botën me të pavërtetat e tyre, për ti kthyer në të vërteta kundër shqiptarëve. Duke e parë këtë gjendje, ne kishim përpiluar një program për zgjidhjen e çështjes shqiptare nën Jugosllavi, me opcion luftën e armatosur, duke u bazuar në parimet e Konferencës së Bujanit, por edhe në dokumentin e vitit 1945 kur Serbia e anekson Kosovën në mënyrë të dhunshme përmes shtettrëthimit ushtarak. Nga lufta në Kroaci, qartazi u kuptua nga të gjithë, se kjo situatë do të

kishte përmasa më të gjëra. Atëherë unë së bashku me Isuf Bajramin dhe intelektual e shokë tjerë duke i përfshirë këtu edhe pjesëtarët e Grupit Revolucionar për Bashkimin e Trojeve Shqiptare i formuar në vitin 1991 në Carrabreg në shtëpinë e Fetnete Ramosajt (tash Heroinë e Kosovës) ishim për bashkimin e forcave në një forcë të unifikuar, por edhe për formimin e një qendre të përbashkët të veprimit dhe koordinimit të aksioneve dhe veprimtarisë ilegale. Disa individë udhëheqës të grupeve ilegale por edhe individ të pavarur që mendonin dhe ishin të bindur se çështja e Kosovës nuk zgjidhet pa luftë, ishin futur në disa parti politike të kohës të cilat i përdornin si mburojë për të vepruar më lehtë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Kurti, 'dardanëve': Me padurim presim fitore ndaj Zvicrës dhe Rumanisë



PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në shoqëri të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, dhe zëvendësministres Daulina Osmani, kanë qëndruar sot për vizitë në kampin e Kombëtares së Kosovës në hotel "Emerald". Presidenti Agim Ademi, duke e falënderuar të parin e ekzekutivit për vizitën, ka shprehur mirënjohjen e tij në emër të FFK-së për mbështetjen që institucionet shtetërore po i japin ekipit kombëtar dhe në përgjithësi futbollit të Kosovës. "Kryeministri është motivues i madh dhe është njeri i aksionit, prandaj e kemi parë të arsyeshme që ai si kreu i qeverisë të vijë sot për vizitë dhe ta japë mesazhin e tij frymëzues për të ecur përpara së bashku", ka thënë presidenti Ademi.

Ndërkaq kryeministri i Republikës i ka falënderuar futbollistët dardanë dhe stafin e kombëtares në përgjithësi për punën e mirë dhe për emocionet e papërshkrueshme që i

japin popullit të Kosovës. "Ju vazhdimisht në ndeshjet e kaluara na keni sjellë emocione dhe ethe. Janë emocione të paharrueshme dhe gëzime të cilat na mbajnë optimistë për të ardhmen. Ju dëshiroj shumë sukses në dy ndeshjet në vijim. E di se me Zvicrën e keni më vështirë edhe për arsye objektive, por besoj se me mbështetjen e ministrisë, me trajnerët që keni dhe me punën ekipore e ushtrimet që do të bëni në këto ditë, do të keni mjaftueshëm energji që edhe në stadiumin 'Fadil Vokrri' më 9 shtator dhe më 12 shtator kundër Rumanisë ta jepni maksimumin dhe ta merrni rezultatin që të gjithë e presin me dëshirë. Faleminderit gjithsecilit për gjithë këtë kontribut, i cili nuk është vetëm sportiv, por është edhe popullor, sepse jo vetëm njerëzit që përcjellin sportin ju ndjekin. Juve ju ndjekin krejt njerëzit që e duan Kosovën", ka theksuar Kurti. Në emër të ekipit kombëtar

kryeministrin me bashkëpunëtorët e tij i ka falënderuar kapiteni Amir Rrahmani. "Faleminderit për përkrahjen ndaj ekipit kombëtar dhe ndaj federatës! Shpresoj që edhe në të ardhmen kontributi dhe ndihma e institucioneve për rritjen e futbollit nuk do të mungojë", ka thënë kapiteni i "dardanëve". Ndërkaq ministri Hajrulla Çeku premtoi se institucionet do të vazhdojnë të qëndrojnë përkrah futbollit dhe ekipit kombëtar. "Ju jeni të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre dy ndeshjeve dhe ne jemi këtu për t'iu ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme si shtet e si institucione, jo vetëm zyrtarisht, por edhe moralisht e me zemër. E keni një shtet dhe shoqëri të tërë mbrapa. Edhe jemi krejt me ju. Dijeni se po e përfaqësoni më shumë se një ekip dhe një sport. Këtu e kemi një gjasë të madhe për të ecur përpara dhe duhet ta shfrytëzojmë. Faleminderit të gjithëve për kontributin që e jepni për shtetin!", ka thënë Çeku.



## SHKURT

### Berisha: Besoj se do të kemi sukses ndaj Çekisë dhe Polonisë

Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë dy ndeshje mjaft të rëndësishme. Me datën 7 shtator përballet me Çekinë në transfertë, më pas do të presë Poloninë në "Air Albania". Portieri Etrit Berisha ka shprehur optimizëm se kuqezinjtë mund të kenë sukses në këto dy ndeshje kualifikuese. "Po bëhemi gati. Të shohim. Jemi mirë. Me motiv shumë të lartë. Besoj se do të kemi sukses", ka thënë Berisha.

### Ballkani përforcohet me talentin Bllaca

FC Ballkani ka njoftuar se ka nënshkruar me futbollistin Arjol Bllacën. Bllaca ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare deri në verën e vitit 2028. "Kemi kënaqësinë ta prezantojmë para jush mesfushorin e ri, Arjol Bllaca, i cili është bashkuar me skuadrën kampione", thuhet në njoftim. 18-vjeçari shkoi te Ballkani nga ekipi i 2 Korrikut. Ai cilësohet një prej talentëve më premtues të futbollit të Kosovës.

### Zeqiri zyrtarizohet te Genku

Genk ka kompletuar transferimin e Andi Zeqirit nga Brighton Hove&Albion. Klubi belg zyrtarizoi sot transferimin e sulmuesit nga Kosova. Zeqiri nënshkroi kontratë trevjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit më shumë. Sipas raportimeve, Genk ka paguar 2.75 milionë euro për transferimin e reprezentuesit të Zvicrës.

### Ajeti ndryshon skuadër, paraqitet te Gaziantepi

Albian Ajeti ka ndryshuar edhe një herë tjetër skuadrën dhe tashmë do të luajë në kampionatin turk. Sulmuesi shqiptar do të jetë pjesë e Gaziantepit në Turqi. Vetë klubi turk ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit 26-vjeçar, i cili nis në këtë mënyrë një aventurë të re dhe për herë të parë do të luajë në Turqi. Së fundmi, sulmuesi ka qenë pjesë e Celticit në kampionatin skocez. Është raportuar se shuma e transferimit mund të jetë deri në 500 000 funte britanike me Celticin që ka marrë një goditje të madhe në financat e tyre. Skocezët kishin paguar 5 milionë funte për ta blerë Ajetin nga West Hami tri vjet më parë. Në të shkuarën Ajeti ka luajtur edhe me skuadra si West Ham në Premierë Ligë, apo edhe Augsburgun në Bundesligë, Sturm Grazin në Austri e skuadra të tjera në kampionatin austriak. Ajeti luan për kombëtaren zvicerane, ndryshe nga vëllai i tij, Arlind Ajeti, që luan në kombëtaren kuqezi.

## Verstappeni: Kjo ishte fitorja më e vështirë e sezonit, i detyrova rivalët të gabonin e të triumfoja

MONZA, 5 SHTATOR - Piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappeni, vendosi ditën e diel rekordin e 10 fitoreve radhazi në Formula 1. Triumfi në garën e Monzas ishte i veçantë për kampionin e botës, që vijon të dominojë. Gjithsesi, ky sukses nuk ishte i

lehtë për të, sidomos në pjesën e parë të garës, ku dueli fort me spanjollin Carlos Sainz (Ferrari). "Nuk e kisha besuar kurrë se do të arrija 10 fitore radhazi. Gjithsesi, sukcesi i fundit në Monza ishte shumë i vështirë. U dërsitëm shumë. Kishim një ritëm të mirë, i

menaxhuam mirë gomat, por Ferrari ishte shumë i shpejtë në vijën e drejtë. Ishte e vështirë ta arrij e parakaloj në kthesën e parë", ka thënë Verstappeni. "Dhashë maksimumin, duke e detyruar Sainzin të gabonte e ta parakaloja. Në një moment ai i

bllokoi fort gomat, ndërsa unë kisha një trajektore më të mirë dhe e kalova në kthesën e dytë. Më pas e pata më të lehtë ta menaxhoja garën edhe pse kisha një problem me motorin në fund, por avantazhi më dha mundësi ta ulja ritmin", është shprehur Verstappeni.



## 'Dardanët' U21 nisin përgatitjet, optimizmi për sukses nuk mungon

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës U21 i ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet e këtij muaji në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2025" kundër Polonisë më 8 shtator si mysafire dhe më pas kundër Gjermanisë më 12 shtator në stadiumin "Fadil Vokri". "Dardanët" e rinj, nën udhëheqjen e përzgjedhësit Afrim Tovërlani dhe stafit të tij, kanë zhvilluar seancën e parë stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali, ku munguan vetëm Andi Hoti dhe Dion Krasniqi, të cilët iu bashkuan ekipit më vonë për shkak të obligimeve me klubet e tyre. Tovërlani është i vetëdijshëm se ekipin e tij e presin dy ndeshje shumë të vështira, kundër dy rivalëve më të fortë në Grupin D, por thotë se djelmoshat e tij do të përgatiten për paraqitje sa më të mira. "Këto janë dy kombëtares më të forta në grup. Qysh në fillim kam theksuar se nuk do t'i frikësohemi askujt, por do të jemi korrektë dhe do t'i marrim me qetësi të dyja ndeshjet sepse kemi të bëjmë me dy ekipe shumë të forta. Është herët të flasim për gjasat tona, sepse kemi



zhvilluar vetëm një ndeshje. Do të jemi të gjymtë me mungesën e Emërllahut dhe Letajt, të cilët janë lënduar dhe do të operohen. Si rrjedhojë nuk do të mund të llogaritim në shërbimet e tyre as në ndeshjet e tetorit e nëntorit", ka bërë me dije Tovërlani.

E sulmuesi anësor i Malishevës, Drilon Hazrollaj, është shprehur i lumtur që është pjesë e Dardanëve

U21 për këto dy ndeshje tejet të rëndësishme. "Është ndjenjë e papërshkrueshme të luash për Kombëtaren e Kosovës. Kjo është një ëndërr për të gjithë futbollistët. Shpresoj se do ta dëshmoj formën e njëjtë siç e kam treguar në kampionatin e Kosovës dhe ta ndihmoj Kombëtaren sa më shumë në ndeshjet e ardhshme", ka theksuar Hazrollaj.

## Van Gaali: Triumfi i Argjentinës në Kupën e Botës ishte i planifikuar

AMSTERDAM, 5 SHTATOR - Në dhjetorin e vitit 2022 Argjentina u shpall kampione e Botës dhe Lionel Messi mund të quhet "zyrtarisht" lojtari më i mirë në historinë e futbollit, por edhe ikonat e këtij sporti shprehin mendimin se triumfi i "Albiceleste" ishte i planifikuar kohë më parë. Argjentina e tekniku Lionel Scaloni mundi me shumë vuajtje "tulipanët" holandezë të Louis van Gaalit, me përballjen që përfundoi me kohën e rregullt 2 me 2 dhe vetëm pas goditjes së penalltive, Messi me shokë siguruan gjysmëfinalen ndaj Kroacisë. Për triumfin e argjentinësve, i cili, sipas tij, ishte i "dyshimtë", ka folur edhe ish-tekniku i Kombëtares holandeze, Louis van Gaal, i cili është i mendimit se çdo gjë ishte e planifikuar paraprakisht



dhe Messi duhet të bëhej kampion bote. "Vërtet nuk dua të flas shumë për këtë. Nëse shikoni se si Argjentina shënoi gola dhe si shënuam ne, dhe si disa lojtarë argjentinës kaluan vijën dhe nuk u ndëshkuan,



mendoj se gjithçka ishte planifikuar paraprakisht. Dua të them atë që mendoj. Messi duhet të bëhej kampion bote? Po, mendoj kështu", u shpreh strategu i bankinës së "tulipanëve".

### SHKURT

#### Inzaghi rinovon kontratën me Interin

Nënkampioni i Evropës, Interi, ka vazhduar kontratën me trajnerin Simone Inzaghi deri në verën e vitit 2025. Klubi italian njoftoi të martën zyrtarisht për arritjen e marrëveshjes me 47-vjeçarin. "FC Internazionale Milano është i lumtur ta njoftojë për rinovimin e kontratës së trajnerit Simone Inzaghi. Falë marrëveshjes së re, trajneri do të jetë në krye të Nerazzurrëve deri në vitin 2025", thuhet në njoftimin e klubit. Inzaghi është pjesë e Interit që nga qershori i vitit 2021. Ai ka fituar katër trofe gjatë kësaj periudhe, dy Kupa të Italisë dhe dy Superkupa të Italisë. Italiani, gjithashtu, udhëhoqi "Nerazzurrët" sezonin e kaluar deri në finalen e tyre të parë të Ligës së Kampionëve pas 13 vjetësh, por pësoi humbje ndaj Manchester City.

#### Capello kritikon Mançinin për kalim në Arabinë Saudite

Kalimin e Roberto Mançinit në Arabi e ka komentuar trajneri legjendar italian, Fabio Capello. Mançini fillimisht e kishte akuzuar presidentin e Federatës së Futbollit të Italisë dhe më pas u zyrtarizua në Kombëtaren e Arabisë Saudite ku do të fitojë 25 milionë euro në sezon. Capello e ka kritikuar për këto veprime Mançinin. "Ai bëri një gabim shumë të rëndë duke e akuzuar presidentin e federatës se nuk ndiente besim, kur në realitet do të ishte më e lehtë të thoshte që kam marrë një ofertë të cilës nuk mund t'i them jo dhe duhet ta pranoj. Mançini vetëm tentoi të justifikojë, duke e akuzuar federatën që ka ndryshuar stafin e tij", ka thënë Capello.

#### Flick rikthen Mullerin pas 9 muajsh te Gjermania

Thomas Mulleri rikthehet te përfaqësuesja e Gjermanisë. Pas nëntë muajsh, Thomas do t'i përfytyrë sërish emocionet e kombëtares dhe kjo vjen pasi sulmuesi i Borussia Dortmundit, Niclas Fullkrug, do të mungojë në këtë grumbullim. Trajneri Hansi Flick i ka besuar përsëri sulmuesit, ndërkohë që Gjermania ka planifikuar dy ndeshje miqësore, fillimisht ndaj Japonisë më 9 shtator dhe tri ditë më pas ndaj Francës. Mulleri ka qenë një nga lojtarët kyç të dy dekadave të fundit të Gjermania, ndërsa 33-vjeçari numëron 121 paraqitje dhe 44 gola me përfaqësuesen dhe për herë të fundit ka luajtur më 1 dhjetor në ndeshjen kundër Costa Rikës në Katar 2022.

#### Enrique: PSG-ja mund të bëjë gjëra të mëdha

PSG-ja në fundjavë arriti fitoren e dytë radhazi në kampionat. Kampionët e Francës e mposhtën Lyonin (1-4), ndërsa pas ndeshjes trajneri Luis Enrique u shpreh i lumtur. "Po, rezultati është shumë i mirë dhe qëndrimi i skuadrës ishte perfekt, por ka ende një rrugë të gjatë për të bërë dhe shumë gjëra për të përmirësuar. Jam i kënaqur me ambicien dhe personalitetin e ekipit. Lidhja Mbappe-Vitinha? Jemi ende në një periudhë në të cilën duhet të krijohen si energji, një periudhë në të cilën i njohim lojtarët, çfarë duam, çfarë kërkojmë. Por është e qartë se kur bashkoni lojtarë me cilësi të lartë, ndodhin gjëra të mëdha", ka thënë Enrique.

## Edhe Carrasco transferohet në Arabinë Saudite

Pavarësisht se në Evropë merkatoja e verës është mbyllur që më 1 shtator, në Arabinë Saudite klubet kanë kohë deri me datën 7 shtator

për t'i bërë përpjekjet e fundit, për t'i forcuar skuadrat e tyre, në kuadër të një sezoni që pritet të jetë spektakolar. Këtë gjë ka bërë dhe skuadra Al-

Shabab, që mbrëmjen e së hënës ka siguruar shërbimet e anësorit belg të Atletico Madridit, Yannick Ferreira Carrasco, për shifrën e 15

milione eurove. Për sa i përket kontratës personale, 30-vjeçari i krahut të majtë të fushës ka nënshkruar një marrëveshje trevjeçare me

arabët, teksa ende nuk dihet sesa do të përfytyrë belgu në "aventurën" e tij të sauditët, por që pritet të mësohet në ditët në vijim.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qëndrim Krasniqi nga Rahoveci shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

Limane Cana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I, II, III, IV të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari".

Deli Bajrami nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

Anita Nrejaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Hysni Zajmi".

Arianti Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Fatih Kepa shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

Nderim Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

Ajan Bata shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Darko Nekic shpall te pavlefshme dëftesën e kl -I- SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Besart Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.

- Loni Caffè SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 811288994.

- Kreshnik Kurti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "TREPÇA".

- Auto Bajra-Bajram E.Tahiri B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811581463.

- SALIH AHMETI, Shpall te pavlefshme dëftesat 10,11,12 DHE DIPLOMEN E SHMLT "ARKITEKT SINANI"

- SARA KABASHI, Shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore ;NONDA BULKA"

- Yll Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Nexhmedin Nixha".

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.t. "Kadri Kusari".

- OsmonSeferi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "FehmiLladrovci" Drenas.

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m.t. "Kadri Kusari".

- Tehnoburimi D.D SH.A shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810548307.

- Ibrahim Bajrami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

- Lejla Peci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Kumrije Rexhepi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal 812051100.

- D.P.T. Instalimi -ASHB shpall të humber arken fiskale me nr. Serik: DG-06603079.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

